



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHKËTET PËR PUSHTETIN VENDOR



Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

Raport 2023

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
KAPITULLI I.....	3
Struktura.....	3
KAPITULLI II.....	5
Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore dhe roli i AMVV si Sekretariat Teknik i tij.....	5
KAPITULLI III.....	7
Integrimi Evropian dhe bashkëpunimi me Projektet.....	7
KAPITULLI IV.....	9
Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SNDQV) 2023-2030.....	9
KAPITULLI V.....	10
Performanca e Bashkive.....	10
KAPITULLI VI.....	11
Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve në nivel vendor.....	11
KAPITULLI VII.....	17
Monitorimi i Planeve të Integritetit dhe asistenca ndaj bashkive për hartimin e planeve të reja.....	17

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2023 Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) ka vijuar mbështetjen ndaj 61 njësive të vetëqeverisjes vendore, për konsolidimin e reformës së decentralizimit dhe procesit të integritit evropian. Në kuadër të përfshirjes në proceset e hartimit të dokumenteve ligjore e strategjike midis të tjerave AMVV ka luajtur një rol kyç (duke kryesuar grupin e punës) në hartimin e Strategjisë për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, Planit të saj të Veprimt 2023-2025, si edhe pasaportës së indikatorëve, si dokumente të një rëndësie parësore, që patën një qasje të qartë gjithëpërfshirëse dhe u realizuan me pjesëmarrjen e një sërë institucionesh shtetërore dhe ku u përfshinë edhe mjaft partnerë zhvillimorë.

AMVV ka forcuar rolin e Këshillit Konsultativ duke nxitur pjesëmarrjen, përfshirjen dhe përfaqësimin e duhur të aktorëve vendorë në të, gjë që ka ndikuar në rritjen e mëtejshme të legjitimitetit të vendimmarrjes që lidhet me çështjet e nivelit vendor. Gjatë periudhës shtator-dhjetor, AMVV ka propozuar disa ndryshime në VKM-në Nr. 910, datë 21.12.2016.

Agjencia ka forcuar punën në dobi të mbështetjes së qeverisjes së mirë, matjes dhe përmirësimit të performancës së shërbimeve publike, rritjes së transparencës e llogaridhënies në qeverisje si dhe mirëmenaxhimit të integritetit institucional në nivel vendor. Një prej objektivave kyç të vitit 2023 ka qenë ngritja dhe forcimi i kapaciteteve dhe burimeve njerëzore vendore, si në nivelin ekzekutiv ashtu edhe në atë përfaqësues. Gjithashtu, AMVV ka vijuar të jetë e suksesshme edhe në organizimin dhe bashkërendimin e aktorëve kombëtarë institucionalë brenda iniciativave dhe projekteve të donatorëve të huaj me fokus mbështetjen e reformës së decentralizimit dhe përmirësimin e modeleve e praktikave të shërbimeve të bashkive ndaj publikut të gjerë.

Në kuadër të zgjerimit me një numër funksionesh dhe kompetencash të reja, AMVV gjatë periudhës nëntor 2023 ka propozuar ndryshim në VKM nr.83 datë 28.01.2015 për ristrukturimin e agjencisë me qëllim përmirësimin dhe rritjen e aftësisë së saj për të kryer me efikasitet funksionet e detyrat aktuale duke i paraprirë detyrave dhe sfidave të shtuara të proceseve integruese në të ardhmen e afërt.

KAPITULLI I

Struktura

AMVV që në krijimin e saj ka pasur një mandat të qartë në funksion të mbështetjes së 61 bashkive të reja të krijuara pas miratimit të reformës administrative-territoriale. Me thellimin e reformës së decentralizimit dhe procesit të integritit evropian, ky mandat është zgjeruar me një numër funksionesh dhe kompetencash të reja. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2023, AMVV ka realizuar ndryshimet e nevojshme në strukturën organizative, resurset dhe kapacitetet e veta, me qëllim që

të përmirësojë dhe rrisë aftësinë e saj për të kryer me efikasitet funksionet e detyrat aktuale duke i paraprirë detyrave dhe sfidave të shtuara të proceseve integruese në të ardhmen e afërt. Struktura aktuale dhe organigrama e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, është përcaktuar me Urdhër të Kryeministrit nr.35, datë 17.03.2023 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes vendore”. Për vitin 2023, organigrama dhe struktura e AMVV janë ndryshuar duke kaluar nga 3 sektorë, në 2 drejtori dhe një sektor. Sipas këtij ndryshimi numri i punonjësve të AMVV shkon në 22, nga 14 punonjës që përfshiheshin në strukturën e vitit 2021. Struktura e agjencisë paraqitet si më poshtë:


I. Drejtoria e Analizës, Monitorimit Strategjik dhe Koordinimit të Vetë-Qeverisjes Vendore

1. Sektori i Monitorimit të Strategjive
2. Sektori për Koordinimin ndërinstytucional dhe Mbështetjen ndaj NjVV-ve

II. Drejtoria e Projekteve, Integritimit Evropian dhe Qeverisjes së mirë

1. Sektori i Performancës për Qeverisjen e mirë
2. Sektori i Projekteve dhe Integritimit Evropian

III. Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse





Aktualisht, marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj agjencie rregullohen me Kodin e Punës. Kriteret specifike dhe procedurat e pranimit në punë bëhen sipas legjislacionit në fuqi dhe nenit 14 të Rregullores së Brendshme aktuale të AMVV-së, miratuar me urdhër të Ministrit të Brendshëm.nr.332 datë 26.10.2022. Duke patur parasysh ndryshimet e strukturës dhe të organikës së Agjencisë sipas urdhrit të Kryeministrit, nr 35, 17.03.2023, lindi nevoja për përmirësimin dhe përditësimin e kuadrit rregullator të brendshëm të AMVV dhe në shtator është përfunduar dokumenti i Rregullores së brendshme të AMVV.

Ndryshimet e strukturës reflektojnë gjithashtu nevojat e institucionit për përmirësim të kapaciteteve të burimeve njerëzore, materiale, për teknologji dhe hapësira pune. Për këtë qëllim gjatë vitit 2023 janë rekrutuar 8 punonjës të rinj. Ky proces do të vijojë edhe gjatë vitit 2024 për rekrutimin e punonjësve të rinj me kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme që do t'i përgjigjen me efikasitet shtimit dhe zgjerimit të kompetencave të Agjencisë në kushtet e thellimit të procesit të decentralizimit dhe Integritimit Evropian. Procesi rekrutues do të synojë të shtrihet edhe tek studentët e ekselencës, për të gërshetuar aftësitë dhe njohuritë e punonjësve me përvojë me kompetencat dhe aftësitë digjitale të të rinjve me rezultate të shkëlqyera në dobi të rritjes së performancës së Agjencisë për arritjen e objektivave të synuara. Po në këtë kontekst, Agjencia ka rritur hapësirat e punës duke u zgjeruar me ambiente të tjera për garantimin e kushteve optimale për punonjësit dhe ekspertët që e asistojnë.

KAPITULLI II

Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore dhe roli i AMVV si Sekretariat Teknik i tij

Një nga funksionet më të rëndësishme të AMVV është roli i saj si Sekretariat Teknik i Këshilli të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore. Ky Këshill është forumi kryesor ku qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projektpolitikat dhe projektstrategjitë që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe e detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Ai institucionalizon procesin e konsultimit mes qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore para vendimmarrjes. Synimi afatgjatë i krijimit dhe konsolidimit institucional të kësaj strukture është

shndërrimi i organeve të vetëqeverisjes vendore në partnerë të rëndësishëm të qeverisjes qendrore për fushat e tyre të përgjegjësisë dhe të drejtave që gëzojnë. Roli i AMVV-së si Sekretariat Teknik i Këshillit Konsultativ realizohet sipas përcaktimit dhe detyrave të ngarkuara në VKM. Nr. 910¹, datë 21.12.2016 i ndryshuar. **Duke ju referuar punës së AMVV si Sekretariatit Teknik**, në këtë raport veprimtaria e Këshillit është vlerësuar nga ana sasiore sipas treguesve që lidhen me drejtimin kryesor të punës së tij që janë numri i projektakteve apo dokumenteve të konsultuara si shprehje të performancës dhe efektivitetit të tij.

I-Konsultimi i projekt akteve ligjore

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 janë zhvilluar 7 mbledhje të Këshillit Konsultativ, përkatësisht në muajt janar, mars, prill dhe korrik të këtij viti. Në Këshill janë paraqitur për diskutim gjithsej 58 projekt-akte ligjore, 1 raport nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe 1 rekomandim nga Avokatura e Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Projektvendimi “Për një ndryshim në VKM .nr 414 “Për miratin e procedurës së ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” është risjellë për konsultim për të dytën here. Nga 58 aktet e sjella për konsultim nga Ministrinë e Linjës janë konsultuar dhe miratuar 39 projektakete në 4 mbledhjet e këshillit konsultativ. Për nga aktet janë 11 projektligje, 42 projektvendime, 1 projekt urdhër, 1 projektakt i rikonsultuar, 1 raport dhe 1 rekomandim, 2 udhëzime. Ndërsa, projektvendimi “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njërive të Vetëqeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar e të punonjësve civil dhe të administratës së NJVV” është miratuar direkt në Këshill të Ministrave.

Përsa i përket këtyre projekt akteve, 12 prej tyre janë paraqitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 4 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 4 nga Ministria e Mbrojtjes, 11 projektakte nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, 2 nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, , 10 nga Kryeministria, 1 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, 5 nga Ministria e Brendshme, 6 nga Ministria e Drejtësisë, 1 akt nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 1 nga Ministria e Kulturës. Të gjitha projektaktet e konsultuara në Këshillin Konsultativ janë miratuar me vendim të bashkëkryetarëve të këtij Këshilli.

Sekretariati Teknik gjatë vitit 2023 ka kryer të gjitha detyrat e parashikuara me ligj duke garantuar infrastrukturën dhe komunikimin e nevojshëm për përgatitjen e për zhvillimin normal të seancave plenare të Këshillit Konsultativ dhe duke mundur realizimin me sukses të mbledhjeve të tij. Në funksionin si Sekretariat Teknik i Këshillit Konsultativ AMVV ka patur prioritet të gjitha hallkat e procesit për përgatitjen, organizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të Këshillit Konsultativ ku përfshihen: dërgimi i dokumentave për njohje dhe konsultim para ditës së zhvillimit të mbledhjes, mbledhja e mendimeve dhe përgatitja e materialeve për bashkryetarët dhe dosjeve për çdo anëtar e të ftuar, përgatitja e draftit të vendimeve të mbledhjes i cili pasi siglohet u dërgohet institucioneve që kanë paraqitur projekte për konsultim së bashku me sugjerimet e këshillit, për t’u hapur rrugë procedurave pasardhëse të miratimit.

¹ VKM-së 910, datë 21.12.2016 “ Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore i ndryshuar”, ku përcaktohet Agjencia për Mbrojtjen e Vetëqeverisjes Vendore në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ

Efektiviteti i funksionimit të strukturës së Sekretariati Teknik, komunikimi i qartë dhe koordinimi i saktë i punës me të gjithë aktorët e përfshirë ka bërë të mundur zhvillimin normal dhe të dokumentuar të veprimtarisë së Këshillit Konsultativ. Kjo gjë ka ndikuar pozitivisht në rritjen e rolit të ST për të siguruar pjesëmarrjen, përfshirjen dhe përfaqësimin e duhur të aktorëve vendorë në procesin e konsultues gjë që ka ndikuar në rritjen e mëtejshme të legjitimitetit të vendimmarrjes që lidhet me çështjet e shtruara për diskutim dhe konsultim.

KAPITULLI III

Integrimi Evropian dhe bashkëpunimi me Projektet

Arritjet në koordinimin e Kapitullit 22 “Zhvillimi Rajonal dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore” gjatë periudhës Janar-Shtator 2023

Gjatë periudhës Janar – Shtator 2023 AMVV ka shërbyer si Sekretariat Teknik për Kapitullin 22.

Kapitulli 22 “Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore”, krahasuar me kapitujt e tjerë në procesin e negociatave të anëtarësimit, ka relativisht pak *acquis communautaire* për t’u miratuar apo kërkesa për ndryshime legjislative. Megjithatë, si për vendet anëtare ashtu edhe për vendet kandidate, përgatitjet për përdorimin e ESIF (Fondet Evropiane Strukturore dhe të Investimeve), zhvillimin rajonal dhe politikën e kohezionit, kërkojnë dhe janë pjesë e transformimit në gjithë procesin e menaxhimit të politikave publike.

Zëvendësministri i Brendshëm në rolin e Kryetarit të Grupit Ndërsinstitutional të Integritimit Evropian (GNPIE) dhe Negociatorit për këtë Kapitull, nën mbështetjen e Sekretariatit Teknik të strukturuar nën AMVV, ka vijuar me punën koordinuese të takimeve të rregullta të Grupit Ndërsinstitutional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) sipas një Plani Pune 2023 të miratuar nga GNPIE.

Gjatë periudhës së kësaj analize raportimi (Janar – Tetor 2023), katër nën-grupet e punës tematike të GNPIE: a) Kuadri rregullator dhe korniza ligjore; b) koordinimi institucional dhe kapacitetet administrative; c) programimi, monitorimi dhe vlerësimi; si dhe d) menaxhimi e kontrolli financiar dhe auditimi; janë bërë operative duke startuar me takimet e para të punës bazuar në njohjen e Rregullores së Dispozitave të Përbashkëta (CPR) për Politikën e Kohezionit, Instrumentet për Vlerësimin e Kapaciteteve Administrative, etj. Puna e GNPIE dhe përbërja e tij përfshin një gamë të gjerë perspektivash, politikash (p.sh. institucionet drejtuese për Programet Operacionale të IPA III), teknike (p.sh. institucionet si Institucioni i Statistikës dhe Agjencia e Prokurimeve Publike), financiare (p.sh. Zëvendëskryetari i Kapitullit 33 Dispozitat Financiare dhe Buxhetore), kontrolli financiar dhe auditimi (p.sh. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Shqiptar të Auditimit), koordinimi dhe mbikëqyrja (SASPAC) si dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Zyra e Zv.Kryeministrit me përgjegjësinë e zbatimit të politikës së zhvillimit rajonal. Takimet e rregullta të realizuara me GNPIE kanë synuar bashkimin e të gjitha institucioneve të përfshira në përgatitjen

e terrenit apo krijimin e ekosistemit të ESIF (Fondeve Strukturore dhe Investimeve Evropiane) si pjesë e faktorizimit të këtyre fondeve në strukturat institucionale.

Në periudhën që parashikon kjo analizë pune (Janar – Tetor 2023) janë realizuar:

- Katër tryeza pune me anëtarët e nën-grupeve të punës të GNPIE të kryesuara nga udhëheqësit e nën-grupeve të punës, nën optikën e përgatitjes për procesin e screening të Kapitullit 22 duke studiuar materialet referuese të vëna në dispozicion nga DG Regio dhe ekspertët. Tryezat e punës kanë pasur në fokus përgatitjen e anëtarëve sipas planifikimit kalendarik në Tetor 2023 për takimin dy-palësh AL- KE;
- Tre trajnime për anëtarët e GNPIE me tematika: European Code of Partnership Principle; NUTs dhe Smart Specialisation; dhe Dispozitat e Përbashkëta të Rregullores;
- Dy trajnime me 61 bashkitë me tematika: Mësimet nga rajoni për Politikën e Kohezionit; si dhe Trajnimi i Përgjithshëm mbi Politikën e Kohezionit;
- Dy takime online në kuadrin e PAR dhe për strukturën e pagave të pushtetit vendor mes Shoqatës së Autonomisë Vendore, bashkive, MB dhe AMVV;
- 4 mbledhje me anëtarët e grupit të punës të GNPIE;
- 1 takim për përgatitjen për takimin bilateral

Aktivitetet e koordinuara nga AMVV janë realizuar në zbatim të Planit të Punës 2023 të Sekretariatit Teknik për Kapitullin 22 me mbështetjen teknike të ekspertëve të Programit të Zvillimit Rajonal 4 financiar nga Swiss Cooperation dhe Austrian Development Agency si dhe UNDP. Gjatë periudhës Tetor-Dhjetor sekretariati teknik i Kapitullit 22 është vendosur pranë SASPAC.

Koordinimi me Zyrën e Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorin

Në zbatim të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025 (PKIE 2023-2025) të miratuar me VKM 122 Datë 01.03.2023, Sekretariati Teknik në AMVV ka asistuar Negociatorin e Kapitullit 22, për aktivitetet monitoruese dhe raportuese 3-mujore për Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociatorin, për ecurinë e Kapitullit 22 dhe në veçanti të akteve nënligjore të parashikuara për Kapitullin 22 në zbatim të Ligjit për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin 102/2020 të cilat monitorohen sipas afateve që përcakton Plani Monitorues i PKIE 2023-2025. Referuar këtij ligji, janë miratuar aktet nënligjore për rajonet e zhvillimit; Bordet e Partneritetit; Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin si dhe procedurat e planifikimit dhe programimit bazuar në Kodin Evropian të Ushtrimit të Parimit të Partneritetit. Sikurse është raportuar nga palët përgjegjëse, Politika Kombëtare për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin si dhe Planet e Zhvillimit Rajonal, kanë qënë në proces draftimi e konsultimi deri në periudhën Janar-Tetor nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit si dhe Zyra e Zv. Kryeministrit.

Për më tepër, Sekretariati Teknik në AMVV, ka asistuar Ministrinë e Shtetit dhe Kryenegociatorin, në koordinimin e mbledhjes së informacionit për takimet 6-mujore të Nën-Komitetit të Transportit, Energjisë, Mjedisit dhe Zhvillimit Rajonal (TEERD). Takimi i 14 i TEERD i thirrur nga DG REGIO u zhvillua në datë 07 qershor 2023, në Tiranë me fokus ndër të tjera në përgatitjen e institucioneve përgjegjëse dhe kontribuese (MB/AMVV, FSHZH, ZV/KRYEMINISTRI, SASPAC, APZHT) në lidhje me zhvillimin rajonal dhe reflektimin e progresit të realizuar nga mbledhja e mëparshme.

Sikurse është kërkuar nga DG Regio, është raportuar për prezencën e dokumenteve aktuale strategjike, të cilat përbëjnë dhe Sistemin e Planifikimit Strategjik (SZHRK). Aktualisht, dokumentet kryesore strategjike janë referuar si më poshtë:

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030, miratuar në Janar 2023 (dokumenti ombrellë për prioritizimin dhe koordinimin e politikave për zhvillim dhe integrim në BE);

- Plani Kombëtar për Integrimin në BE 2023-2025, miratuar në Mars 2023;
- Plani Kombëtar Shqipëri 2030;

Gjithashtu është referuar për strategjitë sektoriale; strategjitë kombëtare ndërsektoriale, si dhe Dokumentin e Politikës Prioritare (PPD) 2021 – 2023, të miratuar nga KPI/Këshilli Kombëtar i Investimeve i cili paraqet një bazë për mekanizmin National Single Project Pipeline (NSPP) dhe siguron përafrimin e projekteve prioritare nga NSPP me Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA). PBA aktualisht është mjeti kryesor i koordinimit ndërmjet dokumenteve të ndryshme të politikave.

KAPITULLI IV

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SNDQV) 2023-2030

AMVV ka luajtur një rol kyç (si kryesuese e grupit të punës) në procesin e hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SNDQV) 2023-2030 (si dhe Planit të saj të Veprimit (PV) e Pasaportës së treguesve (PT), i cilësuar ky një dokument me rëndësi parësore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik-social dhe integrimin evropian të vendit. Strategjia që nga momenti i hartimit deri në përgatitjen e pasaportës së treguesve, kaloi nëpërmjet një procesi gjithpërfshirës, nga poshtë-lart, i cili u kryesua nga Ministria e Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe ku u përfshinë institucionet shtetërore relevante. Gjithashtu kontribut dhanë edhe shoqatat vendore, të partnerëve të zhvillimit si dhe aktorë të tjerë në nivel qendror dhe vendor.

AMVV, në këtë kontekst luajti një rol shumë të rëndësishëm në bashkërendimin e punës dhe kontributit të të gjithë aktorëve të sipërpërmendur deri në finalizimin e dokumenteve të SNDQV, PV dhe PT. Kështu pas përmbylljes së ciklit të konsultimeve me aktorët e përfshirë, ky rol vijoi me paraqitjen e draftit përfundimtar që u konsultua me Aleancën Kombëtare të Këshilltareve për kriterin e integritimit gjinor. Dokumenti i konsultuar përfundimtar u paraqit për shqyrtim në takimin e Grupit Tematik të Decentralizimit. Pas këtij takimi ekipi me përfaqësues nga AMVV-së dhe Drejtoria e Politikave dhe Çështjeve Vendore në Ministrinë e Brendshme, vijuan punën për përfundimin e dokumentit duke reflektuar komentet dhe sugjerimet e të gjithë aktorëve. Në vijim u ndoqën hapat e nevojshme për konsultimin elektronik. Prosesi u finalizua me miratimin e të gjithë paketës dokumentare (Strategjia, Plani i Veprimit dhe Pasaportave e Indikatorëve) **me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 20.4.2023** “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, të planit të saj të veprimit 2023-2025 e të pasaportës së indikatorëve”.

Gjatë kohëzgjatjes 8 vjeçare të SNDQV synohet konsolidimi i procesit të decentralizimit, krijimi i një mjedisi nxitës për zhvillimin ekonomik vendor të qëndrueshëm, forcimi i të ardhurave vendore të bashkive, digjitalizimi i shërbimeve dhe ofrimi i tyre online, sigurimi i një qeverisjeje të hapur, rritja e transparencës, llogaridhënies dhe shtrirje më e madhe e e-qeverisjes në nivel vendor dhe avancimin e agjendës së BE-së në nivel vendor. Për sa më sipër, **kontributi i AMVV do të vijojë të konsolidohet në mbështetje të realizimit me sukses të objektivave të këtij dokumenti strategjik dhe të planit të tij të veprimit.**

KAPITULLI V

Performanca e Bashkive

Ngritja e një Sistemi të Matjes së Performancës (SMP) me qëllim përmirësimin e cilësisë të shërbimeve publike të ofruara në nivel vendor është parashikuar në Ligjin “Për Vetëqeverisjen Vendore” (ligj nr.139/2015) dhe në Ligjin nr 68/2017 “Për Financat Publike Vendore” (buxhetimi i programeve të orientuara drejt performancës dhe rezultateve). Gjithashtu, krijimi i SMP-së dhe Skemës të Granteve Bazuar në Performancë (SGBP) përbën një angazhim të Qeverisë Shqiptare. Ndërkaq, në këtë kuadër, me Urdhër të Kryeministrit nr.17, datë 20.02.2023, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e propozimeve ligjore për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike që ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet sistemit të matjes së performancës së shërbimeve publike. Grupi Ndërinstitucional i Punës kryesohet nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor.

Në këtë urdhër përcaktohet se roli i sekretariatit teknik në mbështetje të veprimtarisë së Grupit Ndërinstitucional të Punës kryhet nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Sekretariati, me mbështetjen e projektit zviceran Bashki të Forta, ka mundur realizimin e 3 mbledhjeve të Grupit Ndërinstitucional të Punës. Mbledhjet janë zhvilluar me pjesëmarrjen e ministrive të linjës, Shoqatës për Autonomi Vendore dhe Shoqatës të Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë. Sekretariati teknik i ka kryer të gjitha detyrat që ka në këtë kuadër duke garantuar infrastrukturën dhe komunikimin e nevojshëm për përgatitjen dhe zhvillimin e mbledhjeve të Grupit të Punës. Në vijim të mbledhjeve, ministrinë e linjës kanë dërguar komentet e tyre në lidhje me materialet pranë AMVV të cilat janë reflektuar në materiale dhe janë parashtruar për vendimmarrje përfundimtare në Grupin e Punës. Në mbledhjet e Grupit të Punës janë dakordësuar: detyrat dhe kalendari i aktiviteteve të Grupit të Punës, faza tranzitore e procesit, koncepti i Sistemit të Matjes së Performancës (SMP), arkitektura e SMP-së, fushat e sugjeruara për tu përfshirë në SMP, si dhe koncepti dhe qëllimi i seminareve të dedikuara të punës për përzgjedhjen e rezultateve dhe indikatorëve në fushat e dakordësuar. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2023 janë zhvilluar 10 seminare të dedikuara pune për përzgjedhjen e indikatorëve sipas fushave respektive. Në këto seminare kanë marrë pjesë **11 ministrinë e linjës** në role udhëheqëse, **ekspertë të fushave, 37 bashki**, SHAV, SHKQSH, **7 organizata ndërkombëtare** si dhe **8 institucione të rëndësishme qëndrore**. AMVV, në rolin e sekretariatit, ka garantuar mbarëvajtjen e këtyre seminareve nëpërmjet përcaktimit të aktorëve kyç dhe komunikimit të nevojshëm, përgatitjen e agjendës dhe materialeve për zhvillimin e seminareve të punës. Në përfundim të çdo seminari, sekretariati ka përgatitur raportet me gjetjet dhe rekomandimet nga tryezat e diskutimit. Raportet janë dërguar

për komente dhe sugjerime të grupet teknike të punës dhe u venos një numër i reduktuar indikatorësh (40) për matjen e performancës.

Në vijim të këtij procesi, janë zhvilluar **2 tryeza konsultuese për përzgjedhjen e treguesve të SMP** për kategorinë e menaxhimit financiar, mirëqeverisjes, mirë administrimit dhe shërbimet publike. Në këto tryeza kanë marrë pjesë përfaqësues nga **42 Bashki**. Treguesit e përzgjedhur u validuan në mbledhjen e radhës të Grupit Ndërinstitucional të Punës. Ushtrimi për matjen e Performancës të bashkive do të zhvillohet gjatë muajve të parë të vitit 2024.

Në kuadër të punës për analizën e situatës në lidhje me standardet e shërbimeve, janë prezantuar tre materiale diskutimi, i pari i cili merr në shqyrtim përkufizimet dhe nocionet bazë në lidhje me Standardet Kombëtare të Shërbimeve publike dhe dy materialet e tjera të cilat sjellin gjetje dhe rekomandime bazuar në eksperiencën e akumuluar në dy shërbime specifike: Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve dhe Arsimi Parashkollor. Në mbështetje të pikës 9 të Urdhrit të Kryeministrit nr.17 datë 20.02.2023, sekretariati teknik ka përgatitur raporte dhe përditësime periodike për institucionet që janë pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës. Gjithashtu, në mbështetje të pikës 10 të këtij Urdhri, është përgatitur raporti 4 mujor për vijueshmërinë e procesit të punës.

KAPITULLI VI

Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve në nivel vendor

Në zbatim të Strategjisë së re të Decentralizimit 2023-2030 (objektivi specifik 6.1; masa 6.1.2), Qeveria Shqiptare synon të zhvillojë dhe forcojë administratën publike vendore, të zgjedhurit vendorë, nëpërmjet një strukture të dedikuar për rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve njerëzore për një qeverisje funksionale, gjithëpërfshirëse. Kjo strukturë synon rritjen e kapaciteteve të nëpunësve publikë dhe të zgjedhurve lokalë për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të tyre e rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të qeverisjes vendore. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore është baza e një qeverisje vendore e cila promovon vlerat demokratike dhe orientohet drejt rritjes ekonomike. Në këtë kuadër, me nismë të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor është iniciuar Urdhri për Ngritjen e Grupit të Punës për zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve dhe të të zgjedhurve vendorë. AMVV ka mbështetur këtë proces me këshillim, lehtësim dhe koordinim. Ndërkohë që draft urdhri është në fazë konsultimi me Ministrinë përgjegjëse, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor organizoi gjatë muajit dhjetor një tryezë konsultimi mes aktorëve të sistemit dhe projekteve donatorë të cilët janë të angazhuar me aspektet dhe aktivitetet për zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve. Në këtë tryezë aktorët e sistemit dakordësuan matricën e bashkëpunimit, e cila synon ofrimin e cilësisë të hartimit dhe zhvillimit të kurrikulave dhe ofrimin të trajnimeve për pushtetin vendor.

Trajnime për pushtetin vendor

AMVV ofron mbështetje të vazhdueshme institucionale në **fuqizimin e kapaciteteve të NJVV-ve** për të forcuar demokracinë vendore nëpërmjet sigurimit të një qasje gjithëpërfshirëse të mirëqeverisjes, përmirësimit të menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor, si dhe rritjes së kapaciteteve administrative vendore me qëllim përmirësimin e ofrimin të shërbimeve publike, objektiva këto të vendosura nga Strategjia e re Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendorë 2023-2030. Në këtë kontekst, pas zgjedhjeve vendore 2023, Agjencia për Mbështetjen e


Vetëqeverisjes Vendore gjatë ndjekjes së procesit ligjor të zhvillimit të mbledhjeve të konstituimeve në 61 Bashki dorëzuar nga një dosje informuese mbi aktet ligjore ku mbështetet veprimtaria e NJVV-ve, si dhe veprimtaria dhe projektet që zbatohen nga NJVV-të:

1. Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
2. Ligji Nr. 115/2014 “Për Ndarjen Administrativo – Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore”
3. Ligji Nr. 68/2017 “Për Financat Vendore”
4. Strategjia Ndërsektoriale për Qeverisjen Vendore
5. Plani i Veprimit për Strategjinë Ndërsektoriale për Qeverisjen Vendore
6. Pasaporta e Indikatorëve të Strategjisë
7. Kapitulli 22 i negociatave me BE dhe roli i bashkive në procesin e integritimit evropian
8. Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit (Masat për Qeverisjen Vendore)
9. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
10. VKM Nr. 910 “Për Këshillin Konsultativ”
11. Shkresë Nr. 6005, datë 05.06.2023 të Ministrisë së Brendshme
12. Projekti “Bashki të Forta”, komponentët dhe objektivat

Një event tjetër në mbështetje të NJVV-ve **ishte dhe takimi prezantues me Kryetarët e Këshillave Bashkiakë**, i zhvilluar në datën 27 korrik 2023, ku u bë prezantimi i kryetarëve të rinj të këshillave bashkiakë me agjendën e decentralizimit në nivel kombëtar dhe atë të AMVV si dhe prezantimin e mbështetjeve teknike të partnerëve ndërkombëtarë për fuqizimin e këshillave dhe këshilltarëve vendorë. Në këtë takim morën pjesë 40 kryetarë të këshillave bashkiakë, 30 prej të cilëve e ushtrojnë detyrën e kryetarit të këshillit bashkiak për herë të parë. Gjatë këtij takimi pjesëmarrësit ngritën disa problematika që lidhen me fuqizimin ekonomik dhe institucional të këshilltarëve, komisioneve dhe sekretariateve të këshillave, që do të ndiqen në vijim nga AMVV.

Gjatë periudhës shtator-dhjetor Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim me projektin **BtF2/Helvetas, ASPA, SHAV, SHKQSH** kanë zhvilluar “ **Trajnimin hyrës për Këshilltarët Bashkiakë**” për **61 këshillat bashkiakë**. Qëllimi i trajnimeve ishte njohja e pjesëmarrësve me legjislacionin themelor që rregullon veprimtarinë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri si dhe me njohuritë bazë që i nevojiten një këshilltari për ushtrimin e detyrës së tij.

- Në këto trajnime kanë marrë pjesë **1000 këshilltarë** nga **1603 (62%)**, ku **80% e këshilltarëve** të trajnuar ishin zgjedhur për herë të parë.
- Pjesëmarrja më e lartë në trajnim ka qënë në **Kolonjë (93,3%)**
- Pjesëmarrja më e ulët në trajnim ka qënë në **Pukë dhe Fushë Arrëz (33,3%)**




AMVV ka ofruar mbështetje edhe për **Trajnimin e Kryetarëve të Rinj të Bashkisë**. Me iniciativë të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, AMVV ka zhvilluar Programin e Akademisë së Liderimit.

Programi i Akademisë së Liderimit (LAP) është një program interaktiv i krijuar nga Qendra e Ekspertizës pranë Këshillit të Evropës, i cili është ideuar për kryebashkiakët, drejtues të niveleve të larta dhe të zgjedhur vendorë. Programi është i përbërë nga tre faza, specifikisht:

- Faza 1: Liderimi në organizatë
- Faza 2: Liderimi Strategjik
- Faza 3: Liderimi për rritje kapacitetesh

Grupi i synuar për këtë cikël të programit përfshinte kryetarët e rinj të bashkive dhe skuadrat e tyre të ngushta drejtuese duke nënkuptuar këtu kryetarët e bashkive respektive pas zgjedhjeve lokale të 2023.

- Pjesëmarrja në këtë program ishte **24 nga 22 bashki (109%)**.
- **Bashkia Finiq** nuk ka marrë pjesë në asnjë prej fazave të programit.




Trajnimi për Metodologjinë e Kapitali Natyror

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe AMVV me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, kanë ndërmarrë një vlerësim metodologjik mbi potencialin e Kapitalit Natyror të Bashkisë (KNB) në Shqipëri. Kapitali Natyror është bërë pjesë e Strategjisë për Decentralizimin dhe Autonominë Vendore 2023-2030 dhe në këtë kontekst, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor synon të shtrijë procesin e vlerësimit në të gjitha bashkitë e vendit. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2023 OSBE në bashkëpunim të ngushtë me AMVV ka zhvilluar **4 takime rajonale** (Vlorë, Elbasan, Tiranë dhe Shkodër) mbi zhvillimin në mënyrë të pavarur të Vlerësimit të Kapitalit Natyror të Bashkisë sipas metodologjisë dhe manualit të zhvilluar nga OSBE.

- Në 4 takime kanë marrë pjesë **37 bashki nga 61 (60,6%)**, ku numri total i pjesëmarrësve ka qenë **79 pjesëmarrës**.
- Pjesëmarrja më e lartë ka qenë në takimin rajonal të zhvilluar në Elbasan me 13 bashki pjesëmarrëse
- Pjesëmarrja më e ulët ka qenë në takimin rajonal të zhvilluar në Shkodër me 9 bashki pjesëmarrëse.

TRAJNIME PËR KAPITALIN NATYROR




Forumi Kombëtar i Qeverisjes Vendore “Bashkitë dhe Procesi i Integritimit Evropian”

Një nga eventet më të rëndësishme të zhvilluara gjatë vitit 2023 ishte Forumi i Qeverisjes Vendore i cili u zhvillua në datë 13 tetor. Ky forum i organizuar me nismën e Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Shoqata për Autonominë Vendore në Shqipëri, me mbështetjen e projekteve të financuara nga BE, “Bashkitë për në Evropë” dhe “BE për Bashkitë” dhe NALAS synonte krijimin e një platforme rajonale për dialog dhe shkëmbim ndërmjet kryetarëve të bashkive dhe ekspertëve të qeverisjes vendore nga Shqipëria dhe Evropa Juglindore për të ndarë praktikat e mira mbi rolin e bashkive në procesin e anëtarësimit në BE dhe instrumentet për të lehtësuar përthithjen e asistencës financiare të BE-së nga autoritetet vendore.

- Në këtë forum morën pjesë **28** bashki nga totali **61 (46%)**

FORUMI I QEVERISJES VENDORE




Trajnimi i Njësive të Integrimit Evropian

Gjatë vitit 2023, AMVV në bashkëpunim me projektin BpE kanë zhvilluar trajnime të vazhdueshme për forcimin e kapaciteteve të Njësitë të Integrimit Evropian, si dhe stafeve drejtuese të bashkive në kuadër të procesit të Integrimit Evropian. Trajnimet e zhvilluara si më poshtë:

- **24** Njësi Integrimi me staf të ri, në total **24 pjesëmarrës**


TRAJNIMI I NJËSIVE TË INTEGRIMIT



Trajnimi rajonal PRAG


Gjatë vitit 2023, AMVV në bashkëpunim me projektin BpE kanë zhvilluar trajnime për procedurat e prokurimeve sipas rregullave të BE-së. Në këtë takim u ftuan të merrnin pjesë bashkitë e qarkut Tiranë, Durrës dhe Dibër.

- **30** bashki pjesëmarrëse nga totali **61 (49%)**



Trajnimi me Sekretarët e Përgjithshëm dhe Nënkyetarët e bashkive mbi “Bashkitë në Procesin e Integrimit Evropian në BE

- **30** bashki pjesëmarrëse nga **61 (49%)**



Workshop TAIEX “Shërbimet Sociale në Nivel Vendor”

- **55** bashki pjesëmarrëse nga **61 (90%)**



AMVV ka ofruar asistencë ndaj NJVV-ve në fushën e menaxhimit të **arsimit parashkollor** si një nga funksione e fundit të decentralizuara te bashkitë e vendit. Në këtë kontekst, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe AMVV, me mbështetjen e projektit zviceran Bashki të Forta, përgjatë vitit 2023 kanë asistuar në komponentin e menaxhimit të arsimit parashkollor në 24 NJVV të reja, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të arsimit parashkollor si një funksion i veti i NJVV-ve. Disa prej ndërhyrjeve që përfshihen në programin e asistencës janë : Trajnimi dhe Ngritje e Kapaciteteve të NJVV mbi modelin e Menaxhimit të Arsimit Parashkollor, dhe Hartimi dhe miratimi i planeve të përmirësimit të shërbimit të arsimit parashkollor të cilat parashikojnë zhvillimin e një numri aktivitetesh.

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, me mbështetjen e projektit Bashki të Forta, përgjatë vitit 2023 kanë asistuar edhe në **komponentin e menaxhimit të integruar të mbetjeve nga NJVV-të**, me qëllim përmirësimin e këtij shërbimi si një funksion i veti i NJVV-ve. Gjithashtu MPV/AMVV dhe projekti zviceran BtF kanë bashkëpunuar ngushtësisht me INSTAT/SALSTAT për trajnimin e bashkive për plotësimin e të dhënave statistikore për grumbullimin, gjenerimin dhe raportimin e të dhënave për bashkitë në fushën e menaxhimit të mbetjeve sipas metodologjisë së adoptuar në datë 22 shtator 2021 me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”. Ky është një proces në vijim dhe i rëndësishëm për arsye se të dhënat e mbledhura nga INSTAT janë të destinuara të përdoren në buletin vjetor për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri. Vihet re se vit pas viti, është rritur efektiviteti i grumbullimit të të dhënave, duke rritur cilësinë dhe koherencën e tyre.

Përgjatë kësaj periudhe Agjencia është angazhuar në bashkëpunim me projektin STAR 3 për vlerësimin e gatishmërisë digjitale në nivel vendor. Sipas objektivit të përcaktuar në SNDQV 2023-2030, është punuar për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm i cili i është paraqitur Komitetit të Programimit Strategjik. Praktika përshkruan fazat e implementimit të projektit “Digjitalizimi i Qeverisjes Vendore”, dhe hapat që do të duhet të ndiqen në vijim.

KAPITULLI VII

Monitorimi i Planeve të Integritetit dhe asistenca ndaj bashkive për hartimin e planeve të reja

Gjatë vitit 2023 AMVV ka startuar edhe procesin e monitorimit të integritetit institucional në nivel vendor. Integriteti institucional dhe lufta ndaj korrupsionit konsiderohen si prioritete kryesore të qeverisë shqiptare dhe janë jetësuar nëpërmjet forcimit të kompetencave dhe kapaciteteve të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, koordinimit dhe zbatimit të nismave anti-korrupsion të parashikara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015- 2023, si dhe të forcimit të kuadrit rregullator dhe të mekanizmave të menaxhimit të integritetit në administratën publike.

Përsa i përket kontekstit vendor, menaxhimi i riskut të integritetit si proces në vetvete rrjedh nga objektivi D i Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen

Vendore (SKNDQV) 2020-2022 për zhvillimin dhe miratimin e politikave anti-korrupsion në nivel vendor si dhe objektivi 11 i SNKK dhe masat përkatëse në Planin e Veprimit 2018-2020 rishikuar 2020-2023. Në këtë kuadër, në zbatim të detyrave dhe objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, me mbështetjen e projektit STAR në 21 bashki të vendit janë hartuar për herë të parë Planet e Integritetit Institucional dhe janë miratuar ato në këshillat bashkiake përkatës.

Kalimi i NJVV-ve nga kodi i etikës tek plani i integritetit institucional, ka shënuar një ndryshim cilësor në lidhje me menaxhimin e integritetit institucional nga ana e tyre si edhe një rritje të profilit qeverisës në raport me qytetarët. Planin e Integritetit si dokument përfshin një listë të përgjithshme të proceseve dhe nënproceseve të punës së institucionit, evidentimin e elementëve të riskut, masat për parandalimin dhe zbutjen e shfaqjeve të korrupsionit, indikatorët e vlerësimit të shkallës së integritetit të institucionit etj.

Sa më sipër, që prej fillimit të vitit 2023, AMVV është angazhuar në procesin e monitorimit të planeve të integritetit (realizimit të masave/aktiviteteve të tyre) të miratuara nga bashkitë. Për realizimin e këtij procesi për vitin 2022, i cili realizohet në vitin pasardhës, AMVV ka koordinuar punën me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) që kanë miratuar tashmë një Plan Integriteti. Monitorimi është kryer në 16 njësi të vetëqeverisjes vendore të cilat kanë hartuar plane integritetit me mbështetjen e projektit STAR. Procesi i monitorimit u zhvillua në bashkitë Mat, Gjirokastrë, Elbasan, Patos, Mallakastër, duke vijuar më pas me bashkitë Belsh, Përmet, Bulqizë, Pogradec, Berat, Pukë, Tiranë, Himarë, Kukës, Maliq, Shijak, Durrës, Lezhë, Kavajë dhe Has (bashkia Roskovec e starton procesin e monitorimit në vitin 2024).

Nga monitorimi rezultoi se në këto bashki është vënë re një progres i qëndrueshëm për sa i përket parametrave të transparencës dhe të zbutjes së riskut të integritetit. Kështu nga monitorimi evidentohet përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, risia e hartimit të planeve vjetore për kualifikimin dhe trajnimin e administratës bashkiake, miratimi i kodit të sjelljes si dhe plotësimi i programeve të transparencës, të cilat janë të publikuara në faqet zyrtare të NJVV-ve. Planet e integritetit kanë sjellë efektet të tjera pozitive në procedurat e prokurimeve publike, qartësimin e detyrave të personelit si dhe rritjen e transparencës me komunitetin veçanërisht në treguesit financiarë. Progres është konstatuar në ngritjen dhe funksionimin e njësisve të sinjalizuesve, gjithashtu janë krijuar e plotësuar regjistrat për shmangien e konfliktit të interesit dhe ai për ankesat dhe kërkesat.

Procesi i monitorimit u përmyll me hartimin e raporteve të monitorimit për secilën prej 16 bashkive, raportit përmbledhës dhe me listimin e përlllogaritjen e indeksit të integritetit sipas metodologjisë së miratuar. **Edhe pse implementohej për herë të parë procesi i monitorimit të zbatimit të planeve të integritetit për NJVV-të u përmyll me sukses duke realizuar treguesin 6.3 sipas Marrëveshjes së Financimit të Bashkimit Evropian² (mbështetjes buxhetore). Më konkretisht, treguesi u realizua në masën 59 % të masave/aktiviteteve të planifikuara për vitin 2022 për bashkitë e monitoruara, duke garantuar në këtë mënyrë alokimin e mbështetjes buxhetore përkatëse, gjë që siguron vijimësinë dhe qëndrueshmërinë e këtij procesi. Ky tregues ka vazhduar deri në fund të vitit 2023.**

² Marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë, për vitin 2020, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II)

Në shtator janë kryer takime me fokus grupet në bashki për hartimin e matricës dhe draftit final për Planin e Integritetit në Bashkinë Librazhd. Këto takime janë kryer në bashki me drejtoritë përkatëse si dhe asistencën e IDM-së. Në tetor dhe nëntor është kryer Hartimi i Planeve të reja të Integritetit në Bashkinë Patos, nëpërmjet vendimit të këshillit bashkiak nr.52, është miratuar plani i ri i integritetit 2023-2025, si edhe në Bashkinë Librazhd, miratohet Plani Integritetit, nëpërmjet asistencës teknike nga AMVV dhe projektit IDM. Në datën 7 dhjetor 2023 është ngritur grupi i punës për monitorimin e planeve të integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Në datën 22 dhjetor 2023 është dërguar email 15 bashkive për të raportuar për zbatimin e masave në Planin e Integritetit të miratuar nga ana e tyre. (bashkitë Belsh, Berat, Bulqizë, Durrës, Lezhë, Maliq, Pogradec, Shijak, Kukës, Himarë, Përmet, Pukë, Tiranë, Kavajë dhe Has). Nga raportimi i bashkive është mbyllur raporti për nivelin e zbatimit të masave për vitin 2023, për të gjitha bashkitë e sipërpërmendura. Në datën 22.12.2023 është dërguar email bashkive për njoftimin e fillimit të monitorimit të strategjisë së decentralizimit për vitin 2023, si dhe caktimit të pikave të kontaktit nga 61 bashkitë. Njëkohësisht është dërguar email institucioneve qendrore për njoftimin e fillimit të procesit si dhe caktimin e pikave të kontaktit, sipas grupit ndërinstitucional të punës për ministritë dhe institucionet qendrore.

Gjatë vitit 2023, janë realizuar planet e reja të integritetit për bashkitë Gjirokastrë, Patos, Mallakastër, Elbasan dhe Mat. Ky proces ka përfunduar me një raport përmbledhës në lidhje me monitorimin e realizimit të masave të parashikuara nga planet e integritetit për vitet 2019-2021, si edhe konsultimet me koordinatorët e integritetit në këto bashki. Brenda vitit 2025 parashikohet që të gjitha bashkitë të jenë të pajisura me plane të integritetit institucional.